

AKT - THEMELIMI
SHOQËRISË "E - TECH" SHPK

Shpallur sot më datë 05.11.2015 nga Ortakët Themelues të Shoqërisë:

Lindita Kaziu, e bija e Mersin dhe Kadrije, shtetase shqipëtare e lindur më 03/07/1972 në Okshtun i Vogel, Diber dhe banuese në Elbasan me adresë Lagja Visarion Xhuvani, Rruga: Rinia, Pallati 575/3, Apt: 3, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me kartë identiteti Nr. Personal: H25703146E

Endri TASE, i biri i Vasilit dhe Natashes, shtetas shqipëtar i lindur më 31/07/1980 në Leskovik, Kolonje dhe banues në Elbasan me adresë Lagja Emin Matraxhiu, P63/2, Apt: 9, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me kartë identiteti Nr Personal. I00731111V

të cilët bazuar në Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 "Për Qendren Kombetare të Rregjistrimit", shpallin sa vijon:

NENI 1
THEMELIMI I SHOQËRISË

Ortakët e Shoqërisë themeluesit Znj. Lindita KAZIU dhe Z. Endri TASE vendosën përshtatjen e Aktit të Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "E - TECH" SHPK, themeluar në 05.11.2015, në bazë të ligjeve Nr. 7512 datë 10.08.1991, Nr. 7632 datë 04.11.1992, Nr. 7638 datë 19.11.1992 dhe Nr. 7667 datë 28.01.1993, duke u bazuar në Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare" nenet 68, 69, 71, 81, 82, 105, 106, 113, 114, 230 dhe 231 të tij, dhe në Ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007 "Për Qendren Kombetare të Rregjistrimit" nenet 22, 26, 32, 35, 43 të tij.

Shoqëria, themeluar me iniciativën e Ortakëve themelues, konsiderohet e themeluar në përputhje me Aktin e Themelimit, përshtatur sa më sipër dhe Statutin e saj bashkëngjitur këtij akti.

Shoqëria i nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do t'i nënshtrohen legjislacionit të vendit ku do të ketë qendrën dega.

Degët e shoqërisë do të ushtrojnë veprimtarinë në emër dhe për llogari të kësaj shoqërie dhe brënda kompetencave që do t'u jenë dhënë me aktet e krijimit apo me akte të tjera të veçanta.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë do të jetë në Elbasan me adresë në Lagja: Visarion Xhuvani, Rruga: Rinia, Pallati 576/3, Apt: 1

Shoqëria do të ketë edhe vënd qëndrime të tjera të dyta, filiale dhe përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me aprovimin e organeve kompetente edhe jashtë tij.

NENI 3 E DREJTA

Shoqëria "E - TECH" SHPK është person juridik i së drejtës shqiptare e themeluar me vendim të ortakëve themelues në datë 05.11.2015 në baze të ligjeve në fuqi për themelimin dhe regjistrimin e shoqërive tregtare, e cila ushtron veprimtarinë e saj tregtare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi: Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare", Ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 "Për Qendren Kombetare të Regjistrimit".

NENI 4 PËRGJEGJËSIA

Shoqëria përgjigjet me pasurinë e saj për detyrimet e saj ndaj të tretëve. Ajo nuk përgjigjet për detyrimet e ortakëve në veçanti, por për humbjet e shoqërisë deri në vlerën e kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar.

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria "E - TECH" SHPK ka për objekt të veprimtarisë së saj:

1. Import-eksport dhe tregëtim me shumicë e pakicë i pajisjeve të telekomunikacionit dhe elektronike. Montim, riparim të sistemeve elektronike të alarmit për mbrojtjen e pronës private apo të objekteve shtetërore. Shitje, montim riparim të sistemeve elektronike të vëzhgimit dhe survejimit të pronës private apo të objekteve shtetërore. Shitje të kompjuterave e sistemeve të tjera kompjuterike, si dhe pajisje ndihmëse të tyre. Projektim dhe montim të sistemeve elektronike industriale peshore elektronike, sisteme elektronike karburantesh (pompa distributore), sisteme elektronike private, industriale lojra, hobby, etj. Projektim, montim dhe shitje të pajisjeve rrjeti "network", pajisje telefonike, centrale telefonike, sisteme komunikimi në distance etj. Servisim, shitje dhe montim i të gjitha llojeve të aparaturave elektronike, shtrepiake, industriale, etj.
2. Në fushën e informatikës: Projektim dhe montim i sistemeve informatike të informacionit. Prodhim, shitje dhe servisim i programeve të ndryshme të kompjuterat dhe sistemet kompjuterike (programe aplikative, games, sport, lloj, hobby, teknike, etj), Kurse për mesimin e kompjuterit e gjuheve të huaja me metodën kompjuterike të të gjitha niveleve. Shërbime internet service provider dhe aplikime në internet. Shërbime salla internet kafe dhe lojra elektronike. Hostim projektim dhe dizënjim i faqeve të internetit. Projektim, ndërtim, aplikim shërbime për salla me lojra elektronike. Tregëtim të artikujve industriale, materiale ndërtimi e hidrosanitare, pjesë këmbimi makineri të çdo lloji, pajisje teknologjike, etj. Import-export i të gjithë artikujve industriale e ushqimore, kompjuterike, kanceleri, leter e produkte të saj, etj. Përpunim e tregëtim kancelerish të ndryshme me shumicë e pakicë. Prodhim e tregëtim

shtypshkrime te ndryshme te prodhuara nga vete shoqeria apo prodhues vendas apo te huaj. Prodhime kompjuterike (desktop) per shtypshkronja e shtepi botuese. Import -export, Prodhim dhe tregetim i te gjitha llojeve te letrave te formateve e peshave te ndryshme, apo nenprodukteve te tyre.

3. Tregëtim me pakice te karburanteve.
4. Ndërtime urbane civile të ndryshme, ndërtim të veprave të artit, punime ndërtimi civile të ndryshme, restaurime etj.
5. Import-eksport dhe tregëtim me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm industrialë dhe bujqësore.

NENI 6 KOHËZGJATJA

Shoqëria e formuar me 04/11/2015 përcakton një afat kohëzgjatje mbi 10 vjet duke filluar nga dita e përshtajes së Aktit të Themelimit dhe Statutit të sajë. Ky afat mund të shkurtohet në rast se shoqëria prishet para kohe.

NENI 7 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njqindmije) lekë i përbërë nga:
Kontributi i ortakut Znj. Lindita KAZIU me 50% të kontributit
Kontributi i ortakut Z. Endri TASE me 50% të kontributit

Vlera e kapitalit themeltar ndahet në 2 (dy) kuota secili nga 1 (nje) kuote.

Kapitali themeltar mund të ndryshojë sipas vendimit që mund të marrin ortakët por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar fillestar në krijimin e Shoqërisë më 04/11/2015. Kapitali është tërësisht i shlyer dhe i nënshkruar

NENI 8 DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Organet drejtuese te shoqërisë do të jenë :

- **Mbledhja e Ortakëve** –Ortakët e Shoqërisë
- Bordi Drejtues i përbërë nga Administratori e kësaj Sh.p.k.-je, Znj. Lindita KAZIU.

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

NENI 9 DREJTIMI TEKNIK I SHOQËRISË

Drejtimi teknik i Shoqërisë do të realizohet nga Bordi Drejtues, anëtarët e të cilit duhet të jetë me arësim të lartë.

NENI 10

Administrator i shoqërisë "E - TECH" sh.p.k. është Znj. Lindita KAZIU

NENI 11

NENI 11

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje "E - TECH" sh.p.k. Elbasan Albania.

NENI 12

BAZA LIGJORE PËR NDRYSHIMET

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin e saj, administratoret, kapitalin, selinë, ortakët, objektin e veprimtarisë etj., sipas vendimit që do të merret nga Mbledhja e Ortakëve - Ortakët e Shoqërisë dhe sipas kërkesave të Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare", duke depozituar vendimin pranë regjistrimit tregtar të Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit.

NENI 13

LLOGARITË

Shoqëria do të realizojë transaksionet e saj financiare nëpërmjet llogarive rrjedhëse që do të hapë në bankat shqiptare dhe të huaja. Për kapitalin themeltar të shoqërisë është hapur libri i llogarive dhe shoqëria ka dhe përdor dokumentacionin financiar në përputhje me dispozitat në fuqi për kontabilitetin.

NENI 14

BILANCI

Veprimet ekonomike dhe financiare të shoqërisë do të mbylLEN në 31 dhjetor të çdo viti. Viti ushtrimor do të përkojë me vitin kalendarik. Vetëm për vitin e parë ushtrimor do të kihet parasysh periudha që shtrihet nga momenti i regjistrimit në organin tatimor deri në datën 31 dhjetor.

NENI 15

PËRFAQËSIMI

E drejta për të përfaqësuar shoqërinë para çdo organi shtetëror, privat, bankar dhe gjyqësor ushtrohet nga Administratori i Shoqërisë ose nga një person tjetër i autorizuar me prokurë prej tij.

NENI 16

ZBATIMI I LIGJIT

Përsa nuk është parashikuar në këtë Akt dhe në Statut, vlejné dispozitat e Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare", Ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Rregjistrimit"

NENI 17

STRUKTURA E KONTRATËS

Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqërisë, të përshtatur në bazë të ligjeve Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Rregjistrimit", do të jenë pjesë përbërëse të strukturës së kontratës së Shoqërisë.

NENI 18
VLEFSHMËRIA E AKTIT TË THEMELIMIT

Shoqëria konsiderohet e riorganizuar dhe e krijuar në përputhje me nenet e këtij Akti Themelimi e të Statutit bashkëlidhur Aktit.

NENI 19

Akti i Themelimit hartohet në disa kopje origjinale, pasi u lexua dhe u gjend konform vullnetit të lirë të ortakut te vetem themelues, nënshkruhet rregullisht prej tij

ORTAKËT

Lindita KAZIU

Endri TASE

Lindita Kaziu

Endri TASE